



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**K.DH.SH.II.nr.826/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES**, Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë në çështjen juridike kontestimore të paditëses NSHTU "Kosovatrans", me seli ne Peje, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.D., kundër të paditurës Komuna e Klinës, në Kline, te cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.Sh., për shkak te kompensimit te dëmit për shkak te shkeljes se markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurës se paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore ne Prishtinë - Departamenti Ekonomik I.EK.nr.289/20 i datës 12.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 19.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Klinës, në Kline, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë - Departamenti Ekonomik I.EK.nr.289/20 i datës 12.05.2021, **VËRETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore ne Prishtinë - Departamenti Ekonomik, me aktgjykimin ankimor I.EK.nr.289/20 të datës 12.05.2021, ka vendosur më sa vijon:

I. Miratohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve Peje", trashëgimtare ligjore e NSHTU "Kosovatrans", me seli ne Peje, e paraqitur kundër te paditurit Komuna e Klinës, ashtu qe detyrohet i padituri qe paditësit t'ia paguaj shumen prej 87,000.00 €, ne emër te kompensimit te demit te shkaktuar përmes rrënimit te objektit te Stacionit te Autobusëve ne Kline, me kamate ne lartësinë e deponimit te mjeteve monetare ne bankat komerciale te vendit, për periudhën e deponimit prej mbi një vit dhe pa destinim te caktuar, duke e llogaritur nga data e paraqitjes se padisë ne gjykatë, 23.09.2008, e deri ne ditën e pagesës, qe te gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit te këtij aktgjykimi.

II. Refuzohet pjesërisht si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit e paraqitur kundër te paditurit, dhe atë ne pjesën nga shuma e miratuar me paragrafin "I" te dispozitivit te këtij aktgjykimi (87,000.00 €), e deri ne shumen e kërkuar me kërkesëpadi, prej 348,890.90 €.

III. Detyrohet i padituri qe paditësit t'ia paguaj shumen prej 430.00 €, ne emër te kompensimit të shpenzimeve te procedurës kontestimore, ne aftin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit te këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor, paditësi ka paraqitur ankesë për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të LPK-së, të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës se dyte, aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshojë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë si të bazuar apo ta anuloj aktgjykimin dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditësit

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e paditësit, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensim demi, ku nga pretendimet ne padi rezulton se me Aktvendimin e lëshuar nga e paditura 04 nr. 353-1029 te dt. 27.08.1987, paditëses i u është lejuar lokacioni për ndërtimin e Stacionit te autobusëve ne njësinë punonjëse ne Kline, toka ndërtimore ngastrën kadastrale nr. 1900/1, evidentuar ne listën poseduese nr. 177, ne vendin e quajtur Dresnik. Sipas kushteve te caktuara dhe Aktvendimeve 04 nr. 353-1029 te dt.27.08.1987, dhe 04 nr. 351-1029/2-87 te dt. 27.08.1987, paditësja ka ndërtuar stacionin e autobusëve ne Kline. Ndërkaq e paditura Komuna ne Kline me dt. 21.09.2007 në mënyrë arbitrare e ka rrënuar Stacionin e autobusëve ne njësinë punonjësve ne Kline pa kurrfarë kompensimi. Mbi bzen e te lartcekurave pala paditëse i ka propozuar gjykatës qe te obligohet e paditura Komuna e Klinës qe paditësit te ia paguaj ne emër te kompensim të dëmit shumen prej 348.890,90 €, me kamate prej 3,5% nga dita e parashtrimit te padisë gjerë ne pagesën e plote, si dhe te ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, ne përgjigje ne padi dhe ne kundërshtimet bëra gjate shqyrtimit gjyqësor, e ka kontestuar ne tërësi kërkesëpadinë e paditësit si te pabazuar, nga fakti se paditësi nuk posedon dokumentacionin valid paraprak dhe te domosdoshëm mbi dhënien mbi shfrytëzim eventual te ngastrës lëndore nr.1900/1 zona kadastrale ne Dresnik lidhur me ndërtimin e stacionit te autobusëve. Prandaj, mungese Vendimit për drejtën e shfrytëzimit apo te drejtën tjetër ne ngastrën lëndore Aktvendimin kontestues e bënë pa baze juridike dhe te paqëndrueshëm. Aktet e lartcekura ne vitin 1987 janë lëshuar pa baze ligjore dhe është lejuar ndërtimi ne toke e huaj, ne kite rast ne token komunale. Nga këto arsye, paditësi nuk mund te dëshmon se nga i padituri mund te kërkon kompensim. Kjo, edhe nga arsyet: fakti relevant është edhe bombardimi nga NATO-ja, dhe shkatërrimi i objektit te ish stacionit te autobusëve ne Kline, i cili pas lufte asnjëherë nuk ka qene i shfrytëzuar nga paditësja, dhe e drejta për shfrytëzimin është zhdukur dhe ka pushuar se ekzistuar. Kompensim te kërkuar, paditësi duhet

te orientoi tek NATOJA e cila strukture ka legjitimitetin real pasiv. Aq me tepër e paditura ne vitin 2006, kishte miratuar vendimin e bordit te drejtoreve për caktimin e lokalitetit te përkohshëm për stacionin e autobusëve ne Kline. Nga arsye te cekura ne përgjigje ne padi, propozoi qe kërkesëpadia e paditësit te refuzohet ne tërësi si e pabaze juridike dhe ligjore.

Duke vendosur sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit te çështjes ka bere administrimin e provave si ne vijim: Aktvendimi 04 numër 353-1029 te datës 27.08.1987; leja për ndërtimin e 04- numër 351-1029/2-87 te datës 27.08.1987; kontrata për ndërtim 1853/1 e datës 14.09.1987, me situacionet e parakohshme dhe procesverbalet për llogaritjen e punimeve te kryera si dhe rekapitullimit, te datës 22.09.2008; certifikata për te drejtën e pronës së paluajtshme; vendimi i Komunës se Klinës me numër 653-476; shkresa e datës 03.10.2008; fotografia e stacionit te autobusëve ne Kline; situacioni i punimeve te kryera te datës 13.10.1987, pagesa pranë SHKSH-se; situacioni i datës 08.12.1987, te cilës i janë bashkangjitur situacioni përfundimtar dhe situacione për punë të kryera; pagesa pranë SHKSH-s e vitit 1989 dhe 1987; Certifikata e Komunës se Klinës me numër 351-348/09; notimi lidhur me asete NS-T Kosovatrans-Peje e datës 10.03.2009; certifikata e Komunës së Klinës 351/348 të datës 06.02.2009; vërejtja e Komunës së Klinës me numër 434/2611 e datës 01.07.2008; dëftesë pagesa e peronizimit për hyrje dalje; njoftimi zyrtare i Komunës së Klinës se datës 16.03.2009; prezantimi i ofertës date 30.04.2009; fatura e tatimit ne prone e datës 16.01.2018 me kartelën financiare për vitet 2002-2005 dhe ekspertiza gjyqësore e ndërtimtarisë e punuar nga eksperti gjyqësorë N.M.. Gjykata e shkalles se parë, pas administrimit te provave dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.289/20 te datës 12.05.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, sikurse në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkalles se parë, ka theksuar se paditësit me Aktvendimin 04 nr. 353-1029 të dt. 27.08.1987 i është lejuar lokacioni për ndërtimin e stacionit te autobusëve në njësinë punonjëse ne Kline ne parcelën nr.1900/1 e cila evidentohet ne listën poseduese nr. 177 për ndërtimin e stacionit te autobusëve ne Kline. Me këtë Aktvendim është parapare se investitori është obliguar ti rregulloi lejen e ndërtimit, e ku paditësi i ka siguruar lejen e ndërtimit 04-nr. 351.1029/2-87 te dt. 27.08.1987, ne baze te Aktvendimit dhe lejes së ndërtimit paditësi NTSH Pejë ka ndërtuar stacionin te autobusëve ne Kline. Sipas vendimit i paditurit për lejimin e lokacionit dhe sipas lejes për ndërtim është ndërtuar stacioni i autobusëve me material te forte çka vërtetohet nga provat e administrua situacionet e bashkangjitur ne shkresat e lëndës, e administruara si prove. Ndërkaq , me dt. 21.09.2007, e paditura komuna Kline-Kline ne mënyrë arbitrare e ka rrënuar stacionin e autobusëve ne njësinë punonjëse ne Kline e cila është ne kuadër te paditëses dhe atë pa kurrfarë kompensimi dhe i lokacioni i ja ka dhënë ne shfrytëzim Shërbimit Policor ne Klinë, për ndërtimin e stacionit të Polices në Klinë. Nga qe u tha me sipër sipas pikëpamjes se gjykatës se shkalles se parë, kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, ndaj si te tille Gjykata e aprovoi. Paditësi ka baze ligjore për dëmshpërblim ne baze te nenit 154 paragrafi 1 dhe 158 te LMD-së, duke pas parasysh se detyrimisht janë përmbushur kriteret dhe atë, qe paditësi te pësoi dem për shkak te veprimit të palejuar dhe kundërligjor te se paditurit dhe i padituri për veprimin e tij është përgjegjës për shkaktimin e dëmit me rrënimin e objektit, qe këto veprime janë ndërmarre dhe janë në kundërshtim me Ligjin. Për demin e shkaktuar është

fajtor i padituri si dhe ekziston lidhja kauzave ndërmjet veprimeve kundërligjore e paditurit dhe dëmeve të shkaktuara. Duke i vlerësuar provat e nxjerra dhe faktet e vërtetuara Gjykata erdhi në përfundim se të gjitha veprimet juridike për mënjanimin e objektit janë marre kundërligjshëm, kjo nga arsyet se poseduesi i objektit në këtë rast paditësi, në rastin e mënjanimin ose rrënimit ka të drejtë për kompensimin e vlerës së objektit. Nuk është kontestues se objekti ka ekzistuar dhe që i njëjti në mënyrë arbitrare është rrënuar. Nga shkresat e lëndës rezulton se objekti është ndërtuar në baze të lejes për ndërtim ka vërtetohet nga dokumentacioni në shkresat e lëndës të administruar si prove. Sipas situacioneve për punët e kryera nr. 2939 të dt. 01.09.1988, në shumën prej 169.782.546 dinarë, dhe procesverbalit dhe situacionet për punët përfundimtare në shumën prej 2.163,777,32 dinarë, të cilat kapin shumën në euro 348.890,90 €. Të njëjtat nuk janë kontestuar (punimet e kryera nuk e kanë pasur vërejtje në situacione) ka do të thotë se investimet nga ana të paditësit janë bërë, dhe objekti është vere në përdorim, si prone e paditësit. Aq më tepër, në dokumentacionin në shkresat e lëndës, stacionin për punët e kryera të nënshkruar nga organi mbikëqyrës, kryesit e punimeve dhe investitorit pa kurrfarë vërejtje, taksativisht ceket se të tera punimet janë kryer, dhe kualiteti i punimeve të kontraktuara janë kryer me kualitet, me ka vërtetohen se të tera investimet për objektin e rrënuar, në këtë dokument është theksuar se të tera punimet janë kryer sipas kontratës dhe është paguar sipas kontratës shuma e lartcekur e vlerës së objektit, ku rezulton se kompensimi i vlerës së objektit e cila është vërtetuar, sipas dokumentacionit edhe nga eksperti financiar ku rezulton se sipas kësaj gjendje të vërtetuar paditësit i është shkaktuar dëm në shumën e gjykuar për shkak të veprimit të palejuar dhe kundërligjor të të paditurit dhe i padituri për veprimin e tij për shkaktimin e dëmit nga arsyet e rrënimit të objektit është në obligim nga arsyet që veprimet janë ndërmarrë në kundërshtim me ligjin, të ia paguaj paditësit shumën e dëmit të gjykuar. Objekti i veçantë i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës në veçanti ishin edhe pretendimet e paditurit se nuk është provuar fakti i funksionalitetit të objektit e cila ishte lëndë e këtij kontesti me pretendimet që objekti është rrënuar nga NATO-ja, dhe se AKP-ja, nuk ka dëshmuar se objekti i përmendur është aset i AKP-s, pasi që dihet se privatizimi në Kosovë, ka filluar në vitin 2002. Këto pretendime janë në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat ishte vërtetuar se objekti ka qene në përdorim edhe pas lufte ka do të thotë se paditësja veprimtarinë e vet e ka kryer në këtë objekt. Duke pas parasysh se paditësja kërkon kompensim dëm për rrënimin e objektit, Gjykata, konsideron se pretendimet e të paditurës janë të paqëndrueshme. Veç kësaj janë të paqëndrueshme edhe pretendimet se AKP-ja, nuk ka si aset objektin e rrënuar. Nga provat e prezantuara se pari prezantimi ortofotos vërtetohet se në vitin 2004, ortofoto e cila është siguruar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, me numrin e protokollit 02/584/09, të dt. 27.04.2009, vërtetohet se ekziston ndërtesa e stacionit të autobusëve në njësinë punuese në Kline, të NSH "Kosovatrans" - Peje.

Sa i përket çështjes kontestuese se cila ishte e objektit në ditën e pastrimit të terrenit nga pala e paditur. Paditësi ka pretenduar se objekti nuk ka qene i bombarduar, ka pasur vlerë financiare dhe do të mund të rikthehej në shfrytëzim, me një investim të vogël. Nga ana tjetër, i padituri ka pretenduar se objekti ka qene i bombarduar gjatë luftës së vitit 1998/1999, atij i ka mbetur vetëm konstruksioni, ka qene i pamjaftueshëm për shfrytëzim dhe nuk ka pasur kurrfarë vlere financiare. Kjo çështje kontestuese, nga gjykata është ndriçuar përmes

nxjerrjes se ekspertizës se ndërtimtarisë dhe provave tjera të ndërlidhura. Eksperti gjyqësor, duke u mbështetur ne ortofoton e vitit 2004 te lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, ka vlerësuar se objekti ne atë kohe kur është bere aeroincizimi. Ne baze te ortofotos dhe shkalles se rritjes se saj, ka ardhur ne përfundimin se objekti kishte je sipërfaqe prej 435 m2. Eksperti ka vlerësuar se duke marre për baze vjetërsinë e objektit, vlera e përafërt e objektit ka qene prej  $435\text{m}^2 \times 200 \text{ €/m}^2 = 87,000.00 \text{ €}$ . Gjykata ia ka falur besimin ekspertizës dhe ka ardhur ne përfundimin se objekti kontestues ne ditën e rrënimit te tij nga i padituri kishte një vlere te përafërt prej 87,000.00 €. Andaj gjykata ne kuptim te nenit 154 dhe 155 te LMD –se ne fuqi, ne kohen e ndodhjes se demit aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e palës paditëse si te bazuar, kurse sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata vendosi ne kuptim te nenit 452.1 te LPK-se.

Gjykata e shkalles se dyte, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, për të cilin aspekt gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK dhe se gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, në ndërkohë që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm dhe i përmbarueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkalles se par. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palëve ankuese as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Andaj pretendimet e tyre mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së shkalles se dyte, nuk qëndrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se shkalles se dyte, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pathemelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e rregullt dhe të drejtë në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton

plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pabazuar, për çka edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Drejtë është vendosur edhe në raport me shpenzimet e procedurës kontestimore pasi që paditësi ka humbur kontestin gjyqësor, ndërsa i padituri nuk ka parashtruar kërkesë të specifikuar sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Nga arsyet e cekura, Gjykata e shkallës së dytë, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES**

**Dhoma e Shkallës së Dytë**

**K.DH.SH.II.nr.826/22 me datën 19.04.2024**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari  
Faton Bajrami**